



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KRYETARI

Nr. 1972 Prot

Polican më 14.09.2021

Vendim

Nr 142 , Datë 14.09.2021

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË APLIKANTËVE NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Në zbatim të nenit 25 , të Ligjit Nr.152/2013 , “Për nënpunësit civil” ,I ndryshuar, si dhe të Kreut III , të Vendimit Nr.242 , datë 18.03.2015, Të Këshillit të Ministrave , “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”,

VENDOSA:

1. Të lejoj që procedura e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese të jetë e hapur dhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil , që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posacme për këto vende, por jo më shume se 20% e numrit total të vendeve në çdo vit kalendarit për Bashkinë Polican.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike.

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KRYETARI

Nr. 1974 Prot

Polican më 14.09.2021

URDHËR

Nr 301 , Datë 14.09.2021

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË BRENDSHËM PËR LËVIZJE PARALELE
,NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIMI NGJA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

Për pozicionin :

- **Drejtor I Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike , kategoria e pagës II/b.**

Në zbatim të nenit 25 , të Ligjit Nr.152/2013 , “Për nënpunësit civil” ,I ndryshuar, dhe të Vendimit Nr.242 , datë 18.03.2015, Të Këshillit të Ministrave , “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Komisionit të brendshëm për pozicionin **Drejtor I Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike** , me përbërjen si vijon :

- **Znj.Luljeta Xhaja ,Sekretari I Përgjithshëm**
- **Znj.Anisa Cenollari ,Drejtoresh e Tatim-Taksave**
- **Znj.Ornela Nurellari ,Specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike**
- **Znj.Shaqe Pupa (Ekspert)**
- **Znj.Monika Kurti (Ekspert)**

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1973 Prot

Poliçan më 14.09.2021

Lënda: Kërkesë për publikim vendesh të lira

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

TIRANË

Bashkia Poliçan, ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit pozicionin e shpallur për konkurim **Drejtor I Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike, kategoria e pagës II/b.** Lloji I diplomës “Shkenca Shoqërore ,Inxhinierike ,Natyrore ose Ekonomike “ niveli minimal I diplomës “Master Shkencor/Profesional”

Për këto arsye , në përputhje me Ligjin nr.152/2013 , “Për nënpunësit civil” ,I ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij , kërkojmë publikimin në portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit “

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1973/Prot

Polican më 14. 09.2021

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, , “***Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese (i ndryshuar)***.”

Institucioni Bashkia Polican shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionet:

- **Drejtor I Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike, kategoria e pagës II/b.**

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Të dyja këto procedura është vendosur të jenë të hapura dhe për kandidat të tjetër jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë (në zbatim të nenit 26/4).

- **Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	
Për lëvizjen paralele	Afati i dorëzimi të dokumnetave 25.09.2021
Për ngritjen në detyrë	Afati i dorëzimit të dokumentave 28.09.2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Përshkrimi i përgjithshëm I punës për pozicionin si më sipër është:

1. Të punojë për ofrimin e punës së administratës së bashkisë me legjislacionin, politikat lokale e rajonale dhe zbatimin e vendimeve të kryetarit dhe këshillit të bashkisë nga i gjithë personeli i bashkisë;
2. Të krijojë lidhje me institucionet vendore, fondacione apo shoqata të ndryshme (OJF), në nivel rajonal e kombëtar dhe hartojë me ta projekte të përbashkëta për trajnimin e administratës, në varësi të detyrave funksionale të punonjësve ;
3. Të përgjigjet për problemet e mbarëvajtjes së shërbimeve logjistike brënda bashkisë ;
4. Të ndjekë mbarëvajtjen e punëve me anë të evidentimit të përditshëm të problemeve që hasën dhe ndihmojë vartësit për eliminimin e të metave;
5. Të propozojë projekte për përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve që ofron bashkia në komunitet, duke i paraqitur tek kryetari i bashkisë
6. Të organizoj punën për rekrutimin e personelit të bashkisë dhe të krijoj kushte për punë normale për personelin e bashkisë nëpërmjet trajnimeve
7. Ndjek dhe zbaton të gjitha kërkesat e Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre.

1 LËVIZJA PARALELE

- Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në insitucionin e Bashkisë Poliçan si dhe në të gjitha insitucionet e tjera pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (**Kategoria II/b**);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

- d- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor/Profesional”(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Shkenca Shoqërore ,Inxhinierike ,Natyrore ose Ekonomike “ niveli minimal I diplomës “Bachelor” ose “Master Shkencor/Profesional”(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
3. Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 25.09.2021

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.09.2021** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit Bashkise Polican ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”
- b) Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
- c) Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- d) LIGJ Nr. 44/20151 Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë
- e) Njohuritë mbi Kodin e Punës
- f) Kodi Penal dhe I procedurës Penale

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 20 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me testimin me shkrim:

Kandidatët do të vlerësohen për ne testin me shkrimi, mbi ligjet e sipërpemendura Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, . Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur dhe për kandidat të tjetër jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në cdo vit kalendarit , neni 26/4).

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor/Profesional”(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1.Të zotërojnë diplomë të nivelit “Shkenca Shoqërore ,Inxhinierike ,Natyrore ose Ekonomike “niveli minimal I diplomës “Bachelor” ose “Master Shkencor/Profesional”(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

2.Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

3. Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së

2.2 DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 28.09.2021, në Institucionin Bashkia Polican

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30.09.2021**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit Bashkia Polican ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- g) Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”

- h) Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
- i) Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- j) LIGJ Nr. 44/20151 Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë
- k) Njohuritë mbi Kodin e Punës
- l) Kodi Penal dhe I procedurës Penale

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Dokumentacioni I dorezuar, Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Institucioni Bashkia Poliçan do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ**

